



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIEVE ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësi/ Org. Org. Unit	ARPI
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	996-2/24
Datum: Date	15.04.24
PRISHTINË / A	
Nr. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.03.2024
REFERENC-Ë:	996/24 - ZSP- ARPI/ 2024
PËR/ZA/TO:	„BALLKAN PETROL“ Sh.p.k. Zona Industriale Gërlicë, K. Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPI-së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investigativ, për shfrytëzim të ujit, me Nr. të protokollit: 996/24, parashtruar nga „BALLKAN PETROL“ Fsh Gërlicë, K. Ferizaj dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 19.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „BALLKAN PETROL” Sh.p.k. për Leje ujore për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Pusi, me nr protokoli 996/24, datë 16.02.2024, K. Ferizaj për fabrikën e prodhimit – Homogjenizimit të vajrave minerale, sipas kushteve vijuese:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga pusi është $Q_{max} = 2.9$ l/s (dy pikë nëntë litra për sekond), sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko – Investiv, në parcelen kadastrale, P-72217029-00362-1, Fsh.Gërlicë e Ultë, K. Ferizaj, nga Pusi me koordinata: (X=7 517 358.86; Y= 4 686 068.45);
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);
3. Për sasinë e shfrytëzuarë pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;

4. Nr. Serik i ujëmatësit, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe i njejti nuk mund të ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborat hidrogjeologjik dhe dokumentacioni investivo - teknik për leje ujore për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Pusi për fabrikën e prodhimit – Homogjenizim të vajrave Minerale në Gërlicë të ulët, Komuna Ferizaj; Procesi i punës dhe procesi teknologjik i prodhimit të vajrave dhe fluideve; Punimet hidrogjeologjike të pusit të hulumtuar, si dhe rezultatet; Certifikata e Biznesit të kompanisë Ballkan Petrol sh.p.k. (810080036); Licencë e Gjeodetit të licencuar, Shkumbin Aliu, Numri i Licences :43; Situacioni i terrenit, në përjesë 1: 2500, ashtu sië kërkohet me U.A 03/2018 për procedurat për leje ujore, si dhe i njejti në kombinim me orto – foto; vendim për dhënjën e Certifikatës së legalizimit, nr i references: 04-351/02-0010880/21, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, K. Ferizaj; vendim për Pëlqim Mjedisor lidhur me projektin për prodhimin – Homogjenizimin e vajrave Minerale në Gërlicë, me Nr: 07/2047/ -ZSP-1540; datë 03.10.2007; Pëlqim mbi masat e e parapara për mbrojtje nga zjarri për nxerrje te lejes ndertimore , me nr 27/03; Certifikata e pronësisë ,me nr P-72217029-00362-1; Kopje Plani për nr 00362-0; certifikata e regjistrimit të biznesit të kompanisë hartuese"INA CONSULTING " Sh.p.k. (811303099), Diplomë e Saranda Nebi Hotit; Diplomë e Esat Bislim Mehani, gjeolog; pala dokumentacionit ia ka bashkangjitur edhe faturat e pagesave me rastine aplikimit , sipas shtojces 6 të U.a 03/2018, për (K.U. ; L.U.) në vlerë prej 300 € si dhe për pëlqim P.U.; në vlerë prej 500 €; , si dhe CD-në; Andaj bazuar në

dokumentacionin e dorëzuar, bazuar në shikimin në vend, datë 14.03.2023, me çrast është vizituar pusi i shfrytëzimit, uji për këtë fabrikë përdoret për punëtor, për pastrim të sipërfaqeve brenda dhe jashtë fabrikës, si dhe uji nuk përdoret fare për proces teknologjik, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 996/24 - ZSP- 2024, datë: 19.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Ferizaj;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Izedin BYTYQI

